

**RREGULLORE**  
**E**  
**NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË TË**  
**KOLEGJIT UNIVERSITAR “TBU”**

**Neni 1**

**Baza Ligjore**

Kjo rregullore hartohet në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri” si dhe Statutin e TBU.

**Neni 2**

**Misioni i Njesise se Sigurimit te Brendshem te Cilesise**

Misioni kryesor i Njesise se Sigurimit te Brendshem te Cilesise (NJSBC) është:

- a) Zhvillimi i një sistemi funksional të vlerësimit të cilësisë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë së arsimit të lartë;
- b) Zhvillimi i një sistemi cilësie të programuar i cili siguron përmirësimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes akademike dhe asaj administrative të “TBU”;
- c) Nxitja e marrjes së masave për funksionimin institucional që synojnë përmirësimin e cilësisë përmes nxitjes dhe kultivimit të kulturës cilësore dhe institucionalizimit të praktikave më të mira.

**Neni 3**

**Fusha e veprimit**

Veprimtaria e NJSBC do të përqendrohet kryesisht në fushat si vijojnë:

1. Strukturat organizative për sigurimin e cilësisë;
2. Subjektet e sigurimit të cilësisë
3. Programet studimore;
4. Procesi i kontrollit të dijeve;
5. Efikasiteti i veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe praktikave profesionale;
6. Burimet njerëzore (stafi akademik dhe ndihmës akademik);
7. Studentët;
8. Diplomimin;

9. Tekstet, literatura, biblioteka dhe laboratorët në universitet;
10. Përkrahja jo arsimore;
11. Ambienti (hapësira arsimore) dhe pajisjet;
12. Veprimtaria administrative dhe financiare;
13. Përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit dhe ekspertët e jashtëm.

#### **Neni 4**

#### **Krijimi dhe statusi i NJSBC**

1. NJSBC është një organ i pavarur që krijohet në rang institucioni me vendim të Senatit Akademik. Ajo menaxhon dhe siguron cilësinë në të gjitha njësitë e “TBU”, si dhe raporton drejtpërdrejtë tek Rektori dhe Senati Akademik.
2. NJSBC përbëhet nga tre anëtare, ku njëri nga anëtarët është nga Qeveria Studentore.

#### **Neni 5**

#### **Parimet e funksionimit të NJSBC**

Në punën e saj NJSBC e “TBU” merr parasysh parimet ligjore, Kodin e Cilësisë dhe parimet e Standardeve dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Parimet kryesore të funksionimit të NJSBC të “TBU”, ‘*midis të tjerash*’ janë si më poshtë:

1. Të mbështesë praktikën e rregullt pasqyruese nga ana e personelit, ekipeve të mësimdhënies dhe strukturave akademike;
2. Të vlerësojë përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të mësuarit me qëllim që të nxisë modelin e një studenti ndërveprues;
3. Të krijojë një kulturë të përmirësimit dhe rritjes së vazhdueshme;
4. Të ndjekë zbatimin e kërkesave ligjore të autoriteteve përkatëse;
5. Të lehtësojë komunikimin e nevojave dhe prioriteteve të të dy palëve brenda hierarkisë akademike apo administrative nisur nga “poshtë lart” dhe nga “lart poshtë”;
6. Të përqendrohet tek studentet përmes adresimit të nevojave të tyre, të tregut të punës dhe ndaj shoqërisë në përgjithësi;
7. Të angazhojë studentët si partner pjesëmarrës gjatë proceseve të sigurimit të cilësisë;
8. Të angazhojë punëdhënësit dhe studentët si ekzekutues të drejtpërdrejtë të politikave dhe procedurave;
9. Të realizojë proceset e sigurimit të cilësisë përmes përfshirjes së vlerësuesve (peer review) të brendshëm dhe të jashtëm;
10. Proceset dhe aktivitetet për sigurimin e cilësisë duhet të bazohem mbi të dhëna dhe sipas rastit, të përfshijnë elemente të vlerësimit të riskut dhe të menaxhimit të tij;

11. Përmirësimi i vazhdueshëm për t'u përgjigjur nevojave të ndryshme nëpërmjet njohjes së metodave të reja të vlerësimit dhe angazhimit;

## Neni 6

### Rolet kryesore të NJSBC

1. Rolet kryesore të NJSBC të "TBU" përfshijnë, por nuk kufizohen në këto si vijojnë:
  - a. *Përgatitja e një raporti vjetor vetëvlerësimi*, që vlerëson cilësinë arsimore në nivel të brendshëm. Ky raport bëhet publik.
  - b. *Rritja e ndërgjegjësimit të brendshëm mbi çështjet e cilësisë* të fakulteteve dhe njësive të TBU për statusin e tyre, e cila nënkupton përcaktimin e metodave për përgatitjen e programeve mbi zhvillimin e cilësisë, për të arritur synimet dhe qëllimet e vendosura nga institucioni.
  - c. *Krijimin e besueshmërisë për vlerësimin e jashtëm*, ku vetëvlerësimi lidh sigurimin e brendshëm të cilësisë me sigurimin e jashtëm të cilësisë.
  - d. *Trajnimin dhe zhvillimin për çështjet e cilësisë*, si dhe kompetencave të tjera funksionale të stafit akademik dhe jo akademik.

## Neni 7

### Funksionet kryesore të NJSBC

1. NJSBC e "TBU" ka *'inter alia'* funksionet si vijojnë:
  - a. Mbështet dhe ofron ekspertizë, e cila nënkupton zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë për të vlerësuar në mënyrë të qartë përdorimin e mësimdhënies, të mësuarit, si dhe metodave moderne të vlerësimit të studenteve me qëllim promovimin e një qasjeje ndërvepruese me studentin në qendër, dhe ngritjen e pyetjeve gjate mësimdhënies dhe mësimnxënies.
  - b. Bashkërendon me fakultete dhe njësi të tjera në TBU, kur siguri i cilësisë konsiderohet i lidhur me dy funksione të tjera: zhvillimi i personelit dhe mbledhja e analiza dhe e të dhënave institucionale.
  - c. Interpreton detyrimet kombëtare dhe evropiane të sigurimit të cilësisë në mënyrë që t'i përshtatë ato në kontekstin institucional, duke garantuar që këto detyrime kombëtare dhe evropiane njihen dhe përfshihen nga TBU.
  - d. Mbikëqyr institucionin, duke ofruar udhëzime, mbledhur informacione, evidentuar probleme, duke bashkëpunuar me fakultetet dhe njësitë e tjera të TBU.
  - e. Administron procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë, që nënkupton se NJSBC duhet:
    - të sigurojë përshkrimin e strukturës së institucionit dhe proceset për sigurimin e cilësisë;

- te ketë përzgjedhur treguesit dhe formatet e tyre, standardet dhe objektivat; te përgatisë formularët standard për çështje të tilla si pyetësorët për studentet dhe pedagoget;
- Të këshillojë mbi procedurat operative për planifikimin dhe zbatimin e proceseve të cilësisë;
- te mbledhë dhe koleksionojë sistematikisht raportet mbi ecurinë, përfshirë të dhënat mbi treguesit dhe objektivat që do të kërkohen për analizën dhe raportimin mbi tendencat në ecurinë e punës dhe ndryshimet në mjedisin në të cilit operon institucioni.

f. Lehtëson krijimin e një mjedisi të favorshëm për arsimim cilësor dhe që vendos studentin në rol aktiv, si dhe maturimin e stafit akademik për të adoptuar njohuritë dhe teknologjitë e kërkuara për një proces me pjesëmarrje aktive gjatë mësimdhënies dhe mesimnxënies.

g. Siguron informacion mbi cilësinë, që nënkupton një shpërndarje të informacionit mbi parametrat e ndryshëm të cilësisë së institucionit për aktoret e brendshëm dhe të jashtëm.

## **Neni 8**

### **Vetëvlerësimi periodik**

NJSBC siguron vetëvlerësimin periodik të TBU dhe të programeve të tij. Vlerësimi nënkupton një proces sistematik të mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave të rëndësishme sasiore dhe cilësore nga burime të shumta dhe të ndryshme rreth programeve arsimore, për qëllimin e përmirësimit të mesimnxënies së studenteve dhe vlerësimin nëse po përmbushen standardet akademike dhe të mesimnxënies.

## **Neni 9**

### **Qëllimet e vetëvlerësimit**

1. Qëllimet e vetëvlerësimit janë si vijojnë:

- a. Te përmirësohen synimet (qëllimet dhe objektivat), përmbajtja, politikat, procedurat, shërbimet, mjedisi organizativ dhe intelektual dhe mbarëvajtja e programit ose vete TBU;
- b. Te nxitet angazhimi i të gjitha aktoreve në TBU, me anë të zbatimit të përmirësimeve të rekomanduara nëpërmjet pjesëmarrjes në procesin e studimit;
- c. Te përmirësohet kapaciteti i programit ose TBU për vetëvlerësim të vazhdueshëm;
- d. Te krijohet baza për vendimmarrje (planifikim) të arsyetuar rreth të ardhmes të njësisë përkatëse;
- e. Te përgatiten materiale me shkrim që mund të përdoren si baze e rishikimit të jashtëm nga kolegjet dhe rishikim nga individët e tjerë brenda institucionit ose sistemit me të gjere.

2. Vetëvlerësimi periodik mund të jetë:

- a. Vetëvlerësim i përgjithshëm;
- b. Vetëvlerësim tematik.

3. Krahas vetëvlerësimit periodik, NJSBC sipas rastit kur del e nevojshme nga analiza e të dhënave dhe informacioneve të marra, apo në rast të administrimit të ankesave nga ana e Keshillave Studentore ose Studentëve, zhvillon edhe vetëvlerësim *'ad hoc'*. Në këtë rast, vetëvlerësimi kufizohet vetëm në treguesit apo çështjet që vihen në pah.

## **Neni 10**

### **Planifikimi**

1. Me qëllim të realizimit të misionit, NJSBC për çdo vit akademik, planifikon të gjitha aktivitetet me rëndësi për sigurimin e cilësisë. Për çdo vit akademik NJSBC përgatit Planin e Punës i cili miratohet nga Senatit Akademik.

2. Plani i punës për vitin akademik përmban fushat vijuese:

- a) Procesi arsimor: numri i nevojshëm i profesorëve dhe bashkëpunëtorëve, planet e punës dhe planet operative për çdo lëndë;
- b) Studentët: numri i studentëve sipas viteve, udhëzime dhe treguese për studime të suksesshme;
- c) Puna kërkimore-shkencore dhe arsimore si dhe veprimtaria botuese, planifikimi i projekteve dhe i publikimeve;
- d) Biblioteka: sigurimin e botimeve të reja;
- e) Hapësira dhe pajisjet: të nevojshme pajisjet themelore për punë;
- f) Anketimet;
- g) Vlerësimi i cilësisë së brendshme.

## **Neni 11**

### **Bashkërendimi**

1. NJSBC në përpushje të detyrave të saja, ka të drejtë të kërkojë të dhëna dhe informacione nga gjithë strukturat e "TBU".

2. Procesi i marrjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave dhe informacioneve të tjera, bashkërendohet me drejtuesit e fakulteteve, njësive qendrore apo strukturave të tjera.

## Neni 12

### Raportet e vlerësimit të brendshëm

1. NJSBC për çdo vit akademik apo vlerësim *'ad hoc'* të kryer harton dhe publikon një raport vlerësimi.
2. Raporti vihet në dispozicion të gjithë strukturave të "TBU" dhe pas paraqitjes dhe shqyrtimit të tij nga Senati Akademik, ai publikohet në faqen e internetit të "TBU".